

VENDIM
Nr. 13/2022

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë.

II. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij:

a) përcaktimin e kriterëve për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë;

b) hartimin dhe përcaktimin e kalendarit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale;

c) përgatitjen e projektit për ndarjen e re administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë.

III. Komisioni i Posaçëm ngrihet mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë. Në përbërje të tij do të ketë 16 anëtarë, nga të cilët 8 janë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, 6 përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Aleanca për Ndryshim dhe 1 përfaqësues i Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim. Emrat e anëtarëve të Komisionit përcaktohen me vendim të Kuvendit.

IV. Komisioni i Posaçëm do të kryesohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

V. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve të tij, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.

VI. Pranë Komisionit ngrihet grupi i ekspertëve teknikë, numri, afatet e punës dhe detyrat specifike të të cilëve përcaktohen me vendim të komisionit.

VII. Komisioni i Posaçëm në veprimtarinë e tij do të zhvillojë konsultime dhe seanca diskutimi me ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore, me përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të shoqatave të zgjedhura vendore, ekspertë të fushës, të shoqërisë civile dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, që mbulojnë çështjet e qeverisjes vendore.

VIII. Çdo parti tjetër parlamentare, e cila nuk është e përfshirë në këtë komision, ka të drejtë të bëjë propozime.

IX. Prezenca e Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, me përvojë në çështjet e qeverisjes vendore, ftohen të ndjekin, të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e komisionit dhe grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

X. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme, kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimmarrja e komisionit do të synojë të arrijë konsensusin për të gjitha propozimet e marra. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë njëkohësisht konsensusin e dy bashkëkryetarëve.

XI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm.

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratur në datën 10.2.2022.